



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHETËTËRORE

Nr. 16336/4 prot.

Tiranë, më 18.9.2018

VENDIM I ASAMBLESË SË AKSIONARIT

Nr. 114, datë 18.9.2018

**PËR
MIRATIMIN E VENDIMIT NR. 18, DATË 10.9.2018 “ PËR
MIRATIMIN E STATUTIT TË RI TË NDRYSHUAR TË
SHOQËRISË “SHOQËRIA E PARË FINANCIARE E ZHVILLIMIT
“FAF” SHA TIRANË.**

Në mbështetje të Ligjit Nr.7926, datë 20.04.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, Vendimit Nr. 642, datë 11.10.2005 të Këshillit të Ministrave “Për Këshillat Mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore” i ndryshuar dhe Statutit të shoqërisë, me cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të shoqërisë “ Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit “FAF” sha Tiranë, pasi shqyrtova vendimin e marrë nga Këshilli Mbikëqyrës;

VENDOSA

1. Miratimin e vendimit nr. 18, datë 10.9.2018 të Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë së Parë Financiare të Zhvillimit “FAF” sha Tiranë “ Për miratimin e statutit të ri të ndryshuar të shoqërisë “ Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit “ FAF ” sha Tiranë.
2. Ngarkohet Administratori i shoqërisë “ FAF” sha Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



S T A T U T I

I

SHOQËRISË “SHOQËRIA E PARË FINANCIARE E ZHVILLIMIT – FAF Sh.a”.

Tiranë, 2018

Neni 1

Emërtimi dhe forma e shoqërisë

Emri i Shoqërisë është “Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit - FAF Sh.a.” me Zyrë të Regjistruar në Tiranë/Shqipëri. Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit- FAF” Sh.a. themelohet dhe funksionon si shoqëri aksionere shtetërore në përputhje të plotë me Ligjin Nr. 9901 të datës 14.04.2008 “*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*”(këtu e më poshtë i quajtur “Ligji i shoqërive”), me Ligjin Nr. 9662, të datës 18.12.2006 “*Për Bankat në Republikën e Shqipërisë*”(këtu e më poshtë i quajtur “Ligji bankar”), me legjislacionin e Bankës së Shqipërisë si dhe në pajtim të plotë me këtë *Statut*.

Në të gjitha aktet e dokumentet që dalin nga shoqëria emërtimi i saj do të ndiqet menjëherë nga inicialet “SH.A”.

Neni 2

Selia dhe Adresa

Selia e shoqërisë “Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit - FAF” Sh.a. është në adresën “*Rruga e Elbasanit, nr. 178/1, Sauk, Tiranë*.”

Vendndodhja e Selisë mund të ndryshojë me Vendim të Asamblesë së Përgjishme të saj.

“Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit - FAF” Sh.a. zotëron një rrjet degësh të shtrirë në zona të ndryshme të Shqipërisë dhe mund të zgjerojë rrjetin e saj të degëve brenda Shqipërisë, duke respektuar kërkesat e ligjit të shoqërive dhe të ligjit bankar.

Neni 3

Kohëzgjatja

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj sipas ligjeve në fuqi dhe këtij Statuti për një periudhë kohe të pakufizuar.

Neni 4

Misioni i Shoqërisë

Misioni i “Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit – FAF” sh.a. është:

Te siguroje produkte, mbështetje dhe ekspertize financiare e me gjere, direkt apo nepermjet partnereve te vet per sipermarrjet, familjet dhe komunitetet ne zonat rurale, suburbane dhe turistike duke ju mundesuar atyre rritje te shpejte dhe te qendrueshme te te ardhrave dhe mireqenies.

Neni 5

Objekti i Veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së “Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit – FAF” sh.a. është ofrimi i shërbimeve financiare që përmbliken si vijon:

- a) Të gjitha format e kredi-dhënies duke përfshirë kredinë hipotekare e konsumatore;
- b) Ofrimin e garancive, marrjen e angazhimeve;
- c) Shërbime Këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera ndihmëse për veprimtaritë e listuara më sipër
- ç) Shërbime të tjera financiare të lejueshme aktualisht dhe/ose në të ardhmen me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e autoritetit license-dhenës.

KREU II

Neni 6

Kapitali i Regjistruar

Kapitali i nënshkruar dhe plotësisht i paguar i Shoqërisë është 1. 144.800.000 (një miliard e njëqind e dyzetë e katër milion e tetëqind mijë) lekë.

Kapitali ndahet në 11,448 (njëmbëdhjetë mijë e katërqind e dyzetë e tetë) aksione të zakonshme me një prerje për vlerë nominale 100,000 (njëqind mijë) Lekë/për aksion.

Numërimi i aksioneve fillon nga numëri 1(një) deri në numërin 11,448 (njëmbëdhjetë mijë e katërqind e dyzetë e tetë), përfshirë edhe numërin e aksionit të fundit. Cdo aksion është i pandashëm dhe siguron të drejtën e një vote.

Neni 7

Përkatësia Kapitale

Pronar i aksioneve “Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit – FAF” sh.a. është Shteti Shqiptar i përfaqësuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë.

Aksionet e themeluesve në kapitalin e shoqërise janë në përputhje me kontributin e tyre të mëposhtëm:

Aksionari themelues: Ministri i Financave dhe Ekonomisë; *numri i aksioneve:* 11,448 (njëmbëdhjetë mijë e katërqind e dyzetë e tetë) dhe *vlera e aksioneve:* 1. 144.800.000(një miliard e njëqind e dyzetë e katër milion e tetëqind mijë) lekë; *vlera e kontributit:* 1. 144.800.000 (një miliard e njëqind e dyzetë e katër milion e tetëqind mijë) lekë.

Neni 8

Zmadhimi i Kapitalit

Kapitali i “Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit – FAF” sh.a.mund të zmadhohet sipas modaliteteve që përcaktohen në nenet 168 deri 180 të Ligjit të Shoqërive.

Zmadhimi i kapitalit mund të kryhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me piken 1 të nenit 145 të Ligjit të Shoqërive.

Neni 9

Zvogëlimi i Kapitalit

Kapitali mund të zvogëlohet vetëm sipas modaliteteve dhe metodave të përcaktuara në nenet 181 deri 186 të Ligjit të Shoqërive, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 10

Shitja dhe Transferimi i Aksioneve

Shitja dhe transferimi i aksioneve të zotëruara nga Shteti Shqiptar i përfaqësuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë do të kryhet sipas parashikimeve të Ligjit të Shoqërive.

Neni 11

Të Drejtat dhe Detyrimet që Lidhen me Aksionet

Çdo aksion i jep të drejtë zotëruesit të tij të marrë pjesë në fitimin vjetor të Shoqërisë, në përpjestim me kuotën-pjesë të kapitalit që ai përfaqëson. Në rast likuidimi, aksionerët përgjigjen për të gjitha detyrimet e Shoqërisë ndaj palëve të treta dhe për të gjitha humbjet e saj deri në vlerën nominale të aksioneve që zotëron.

Të drejtat dhe detyrimet aksionere të ndjekin aksionin në fjalë në çdo moment dhe rrethanë.

Aksioni i jep zotëruesit të tij të drejtën e votës dhe të përfaqësimit në Asamblenë e Përgjithshme në kushtet e parashikuara nga ligji ose të caktuara në këtë statut.

Aksionet janë të pandashme kundrejt shoqërisë.

Neni 12

Organet Drejtuese të Shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë janë

- 1- Asambleja e Përgjithshme
- 2- Këshilli Mbikqyrës
- 3- Administratori

Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme përfaqësohet nga Ministri i Financave dhe i Ekonomisë. Të drejtat e aksionarëve, për çështjet e lidhura me veprimtaritë e funksionimin e shoqërisë, ushtrohen nëpërmjet Asamblesë së Përgjithshme.

Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:

- a) përcaktimin e politikave tregtare;
- b) ndryshime të statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës,
- ç) emërimin dhe shkarkimin e administratorit
- d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- dh) miratimin e skemës së shpërblimeve për anëtarët e Këshillit Mbikqyrës, të likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar.
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- f) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
- g) pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
- gj) ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
- h) përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve Mbikqyrës;
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- j) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
- k) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti.

Asambleja e Përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e Këshillit Mbikëqyrës dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.

Të gjitha kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme të parashikuara nga ligji i shoqërive dhe në këtë Statut ushtrohen nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë me cilesinë e Aksionarit të vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga Aksionari i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet e mëposhtme:

- a) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve;
- c) zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
- ç) vendimet për investime;
- d) riorganizimi dhe prishja e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për

Neni 14

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara nga ligji i shoqërive ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratorët dhe Këshilli Mbikëqyrës apo nga Aksionerët të cilët zotërojnë aksione, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë

Asambleja e Përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton apo parashikohet qartë se humbjet arrijnë në një vlerë të barabartë me 50 për qind të kapitalit të regjistruar ose që aktivet e shoqërisë nuk mbulojnë detyrimet, që janë të kërkueshme brenda 3 muajve në vijim.

Asambleja e Përgjithshme thirret, kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Neni 15

Mënyra e thirrjes

Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik dhe rendi i ditës u

dërgohen të gjithë aksionarëve, jo më vonë se 21 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Njoftimi ndërmjet të tjerash duhet të përmbajë:

- a) emrin e shoqërisë, selinë e regjistruar, vendin dhe orën e mbledhjes së asamblesë;
- b) një sqarim të hollësishëm të procedurave, që duhet të ndiqen nga aksionarët, për të marrë pjesë dhe votuar në asamble, e cila duhet të përfshijë:
- i) të drejtat e aksionarëve, sipas nenit 139 të ligjit të shoqërive;
- ç) adresën e faqes së internetit të shoqërisë etj.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të percaktuar në statut, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 16

Rendi i ditës

Rendi i ditës i mbledhjes së asamblese percaktohet nga autori i thirrjes. Rendi i ditës, duhet të përmbajë edhe vendimet e propozuara për çdo çështje.

Nëse Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për ndryshimin e statutit, teksti i ndryshimeve duhet të njoftohet së bashku me rendin e ditës.

Administratorët duhet t'i përgjigjen, me shkrim, çdo kërkesë me shkrim për sqarim për rendin e ditës, dërguar nga aksionarët jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 17

Përfaqësimi në Asamblenë e Përgjithshme

Administratorët dhe anëtarët e Këshillit Mbikqyrës nuk mund të veprojnë si përfaqësues të aksionarëve në asamblenë e përgjithshme.

Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të aksionarit të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të aksionarit përfaqësuar.

Neni 18

Këshilli Mbikqyrës

Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga 6 (gjashtë) anëtarë. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës emërohen dhe shkarkohen nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë. Kohëzgjatja e funksionit të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës është 3(tre) vjet dhe janë të rizgjedhshëm.

Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës janë persona fizik dhe nuk mund të kryejnë funksione administrimi dhe duhet të jënë të pavarur. Anëtarë të pavarur të Këshillit Mbikqyrës vlerësohen personat, të cilët nuk kanë konflikt interesash, sipas përcaktimit të pikës 3 të nenit 13 të ligjit të shoqërive.

Nëse një ose disa vende të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës mbeten bosh, për shkak vdekje, shkarkimi ose dorëheqjeje, zëvendësimi duhet të kryhet jo më vonë se 3 (tre) muaj.

Neni 19

Kryetari dhe Zv. Kryetari i Këshillit Mbikqyrës

Këshilli Mbikqyrës zgjedh ndërmjet anëtarëve të tij një Kryetar dhe një Zv. Kryetar, të cilët thërrasin mbledhjen e Këshillit dhe drejtojnë diskutimet. Këta zgjidhen për të gjithë kohën e mandatit të tyre dhe janë të rizgjedhshëm.

Këshilli Mbikqyrës mund të ngarkojë një person si sekretar edhe jashtë anëtarëve të tij.

Në rast mungese ose pengimi të Kryetarit, mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës drejtohen nga Zv. Kryetari.

Neni 20

Vendimet e Këshillit Mbikqyrës

Këshilli Mbikqyrës mbledhet sa herë që e kërkon interesi i shoqërisë, por jo më pak se katër herë në vit, me thirrjen e Kryetarit, ose, në mungesë të tij, të Zëvendës Kryetarit të Këshillit Mbikqyrës. Në parim, thirrja duhet të bëhet 5 (pesë) ditë pune përpara me letër /telegram /fax /e-mail. Çdo thirrje duhet të përmbajë rendin e ditës, datën, orën dhe vendin

e zhvillimit të mbledhjes. Këshilli Mbikëqyrës mund të thirret me përpara se 5 (pesë) ditë pune me dakordësinë e të gjithë anëtarëve.

Rendi i ditës caktohet nga Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës në bazë të programit vjetor të aktivitetit të tij, të miratuar në fillim të vitit. Këshilli Mbikëqyrës mund të shqyrtojë edhe çështje të tjera që propozohen gjatë vitit nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe/ose Administratori.

Mbledhja e Këshillit Mbikëqyrës zhvillohet në selinë e Shoqërisë ose në çdo vend tjetër që përcaktohet në thirrje. Këshilli Mbikëqyrës mund të marrë vendim të vlefshëm vetëm nëse janë të pranishëm jo më pak se $\frac{1}{2}$ e anëtarëve të tij.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, vendimet e Këshillit Mbikëqyrës, merren me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm.

Në rast barazimi të votave, vota e Kryetarit është përcaktuese.

Këshilli Mbikëqyrës mban regjistrin e pjesëmarrjes në çdo mbledhje që nënshkruhet nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Për çdo mbledhje të Këshillit Mbikëqyrës, sekretari i Këshillit Mbikëqyrës mban procesverbalin e mbledhjes ku pasqyrohen:

- Data dhe vendi i mbledhjes
- Pjesëmarrësit në mbledhje
- Rendi i ditës
- Drejtuesi i mbledhjes
- Përmbledhje e materialeve të mbledhjes
- Diskutimet e pjesëmarrësve
- Rezultati i votimit dhe vendimet e marra.

Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës evidentohen në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës që kanë marrë pjesë në votim.

Kopjet e vendimeve vërtetohen nga Kryetari ose në mungesë të tij nga Zëvendës Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës.

Neni 21

Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës

Këshilli Mbikëqyrës ka këto të drejta dhe përgjegjësi:

a) të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratrët;

b) të përgatisë, me kërkesë të asamblesë së përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;

c) të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;

ç) të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;

d) të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;

dh) të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecures së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratë. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë e anëtarët e Këshillit Mbikqyrës për t'iu paraqitur Asamblesë së Përgjithshme, së bashku me një raport të Këshillit Mbikqyrës për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;

e) të sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur dhe raporti i auditimit, drejtuar asamblesë së përgjithshme, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës.

ë) të miratojë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare, të certifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emitimit të obligacioneve apo instrumenteve të tjera të borxhit;

f) të vendosë krijimin e bashkëpunimeve tregtare afatgjata dhe propozimin e politikave, për themelimin e shoqërive tregtare ose të grupeve të reja

g) të miratojë në parim fondet për shperblimet shtese për punonjesit e shoqërisë sipas propozimit të paraqitur nga Administratori

gj) të kryejë veprimet e tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Këshilli Mbikqyrës ka të drejtë të kryejë në çdo kohë verifikime dhe kontrole, që ai i cmon të përshtatshme dhe të njihet me dokumentacionin që e gjykon të nevojshëm për përmbushjen e detyrës së tij.

Administratori paraqet raport Këshillit Mbikqyrës të paktën një herë në tre muaj. Brenda tre muajve nga data e mbylljes së ushtrimit financiar, Administratori duhet t'i paraqesë Këshillit Mbikqyrës llogaritë vjetore për qëllim verifikimi dhe kontrolli.

Neni 22

Përgjegjësitë e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës

Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës dhe Administratorit përcaktohet sipas ligjit të shoqërive.

Neni 23

Largimi i Anëtarëve të Këshillin Mbikëqyrës

Detyra e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës përfundon në rast se:

- a) personi pushon së qeni anëtar i Këshillit Mbikëqyrës në bazë të dispozitave të ligjit të shoqërive referuar parashikimeve të pikës 4 të nenit 167 dhe nenit 157;
- b) personi vuan apo mund të vuajë nga çrregullime mendore;
- c) personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë, ose
- d) ka munguar për më shumë se gjashtë muaj rradhazi pa lejen e anëtarëve të tjerë të Këshillit Mbikëqyrës në mbledhjet e këtij këshilli të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe Asambleja e Përgjithshme, me propozim të Këshillit Mbikëqyrës, vendos ta shkarkojë nga detyra.

Neni 24

Shpërblim i Anëtarëve të Këshillin Mbikëqyrës

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës përfitojnë pagese mujore skema e të cilës përcaktohet me VKM . Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës mund të përfitojnë dhe shpërblime shtesë me miratim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 25

Administratori

Administratori emërohet nga Asambleja e Përgjithshme. Kohëzgjatja e mandatit të Administratorit është 3 (tre) vjet me të drejtë riemërimi.

Nëse një anëtar i Këshillit Mbikëqyrës emërohet Administrator i shoqërise, mandati i tij në Këshillin Mbikëqyrës përfundon.

Nje person nuk mund të emërohet Adminsitrator në më shumë se një shoqëri.

Paga e Administratorit caktohet nga Këshilli Mbikëqyrës në aktin e emërimit të tij. Administratori mund të përfitojë shpërblime shtesë me propozim të Këshillit Mbikëqyrës dhe miratim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 26

Zëvendësimi i Përkohshëm i Administratorit

Këshilli i Mbikqyrjes mund të ngarkojë një anëtar Këshilli për të zëvendësuar përkohësisht Administratorin, kur gjendet në një nga rastet e mëposhtme:

1. Për sëmundje të gjatë, ku mungesa e Administratorit do të cënonte vijimësinë normale të ekzekutimit të detyrave të tij,
2. Për rrethana të dorëheqjes ose të vdekjes dhe kur për pasojë është e pamundur që të emërohet menjëherë një tjetër Administrator.

Neni 27

Kompetencat e Administratorit

Administratrët kanë të drejtë dhe detyrohen:

- a) të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
- b) të përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) të kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) të përgatisin dhe të nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilët ia paraqesin Këshillit Mbikqyrës për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për t'u paraqitur më pas për miratim nga Asambleja e Përgjithshme;
- d) të krijojnë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;
- dh) të kryejnë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të ligjit të shoqërive apo të ligjeve të tjera;
- e) të raportojë përpara Këshillit Mbikqyrës për zbatimin e politikave tregtare dhe, me realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë, për veprimtarinë e shoqërisë;
- ë) t'i propozojë për miratim Këshillit Mbikqyrës fondin për shperblime shtese te punonjese, ne perputhje me mbarevajtjen ekonomike dhe financiare te Shoqerise.
- f) të kryejnë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Detyrat, që ligji i shoqërive ia cakton Këshillit Mbikqyrës, nuk mund t'u delegohen Administratorëve.

Në rastet e parashikuara në pikat 3, 4 e 5 të nenit 136 të ligjit të shoqërive, Administratrët duhet të informojnë menjëherë Kryetarin e Këshillit Mbikqyrës.

28

Komiteti i Auditimit

Komiteti i Auditimit përbëhet nga 3 (tre) anëtarë. Anëtarët emërohen dhe shkarkohen nga Këshilli Mbikqyrës. Kohëzgjatja e funksionit të anëtarëve është për një periudhë 3-vjecare, me të drejtë rizgjedhje vetëm 1 herë. Anëtarët e Komitetit të Auditimit janë individë me jo më pak se 5 vjet eksperience në fushën e kontabilitetit ose auditimit, të cilët nuk mund të jenë punonjës ose drejtues ekzekutiv të shoqërisë.

Komiteti i auditimit ka këto detyra:

- Te ndihmojë në përforcimin e linjave të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm, në funksion të përmirësimit të vendimmarrjes së Këshillit Mbikëqyrës dhe administratorëve të shoqërise.
- Bën vlerësimin dhe mbikqyr marrëdhëniet e shoqërise me audituesit të pavarur;
- Mund t'i propozojë Këshillit Mbikqyrës emërimin dhe shkarkimin e drejtuesit dhe punonjësve të Njesisë së Auditimit të Brendshëm.
- I jep mendim Këshillit Mbikqyrës për të gjitha problemet që i kërkojnë prej këtij të fundit;

Komiteti i Auditimit raporton përpara Këshillit Mbikqyrës dhe e ndihmon këtë të fundit në vendimmarrjen dhe mbikqyrjen e shoqërisë. Komiteti i Auditimit, gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, mund të ndihmohet nga ekspertë të jashtëm të zgjedhur prej tij. Asambleja e përgjithshme vendos për shpërblimin e anëtarëve të Komitetit të Auditimit. Funksionimi i Komitetit të Auditimit përcaktohet me rregullore të veçantë të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës.

Eksperti Kontabël i Autorizuar /Shoqeri ekspertesh

Asambleja e Pergjithshme zgjedh dhe emeron auditorin e pavarur. Procedura e perzgjedhjes kryhet ne perputhje me parashikimet e Ligjit të Shoqërive.

KREU IV

Neni 29

Kontabiliteti, Inventarët, Gjendja Financiare

Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj kontabël në përputhje me dispozitat e Ligjit “Për Kontabilitetin”, si dhe në përputhje me rregullat specifike kontabël për veprimtarinë e institucioneve të shoqërisë financiare.

Një herë në 12 muaj, përpara përgatitjes së gjendjes financiare vjetore, Shoqëria kryen inventarizimin e zotërimeve (aktiveve) dhe të detyrimeve (pasiveve) të saj.

Në fund të çdo vitit financiar, por jo më vonë se 3 muaj nga data e fundit të vitit, Shoqëria përgatit gjendjen financiare vjetore, sipas rregullave të përcaktuara për këtë qëllim në legjislacionin përkatës.

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përgjashtimisht ushtrimi i parë financiar përfshin kohën nga data e regjistrimit në regjistrin tregtar deri më 31 Dhjetor.

Neni 30

Rezultati Ushtrimor dhe Përcaktimi i Fitimit

Rezultati i ushtrimit përcaktohet si diferencë ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të ushtrimit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm.

Nga fitimet e ushtrimit, të pakësuara kur është rasti me humbjet e mëparshme, hiqet të paktën 5% (pesë për qind) për të krijuar rezervën e domosdoshme. Heqja nga fitimet për rezervën e domosdoshme nuk është e detyrueshme, kur kjo rezervë arrin 1/10 (një të dhjetën) e kapitalit themeltar. Ajo rifillon për një arsye çfarëdo, kur rezerva e domosdoshme ka zbritur nën 1/10 (një të dhjetën) e kapitalit.

Neni 31

Përdorimi i Fitimit Neto

Fitimi neto i shoqërisë destinohet për drejtimit e mëposhtme:

1. Për Rezerva të Detyrueshme që përcakton Ligji i Shoqërive si dhe për drejtime të tjera që përcaktojnë Aksionerët e Shoqërisë.
2. Për Rezerva të tjera të Detyrueshme që përcaktohen nga kërkesat për vetë-mjaftueshmëri kapitale.
3. Për investime dhe drejtime të tjera të miratuara nga Aksioneri.
4. Për rritjen e Kapitalit.
5. Për Shperblime Shtese te punonjesve
6. Per Dividendë.

Për krijimin e rezervave të lira duke zbritur pjesë nga fitimi, vendos Asambleja e Aksionerëve. Rezervat e Lira përdoren për qëllim zhvillimi të vetë Shoqërisë.

Neni 32

Bartja e Humbjeve

Pas miratimit të gjendjes financiare të Shoqërisë, humbja e rezultuar në vitin financiar përkatës mund të kalojë në rezultatin financiar të vitit vijues, me qëllim që të mbulohet me fitimet e ardhshme deri në shuarje të saj.

Në këtë rast, Shoqëria detyrohet të respektojë rregullat e vendosura nga Banka e Shqipërisë, sipas kërkesave të kësaj.

Neni 33

Rezerva të Përgjithshme

Rezervat e Përgjithshme të Shoqërisë së Parë të Zhvillimit FAF Sh.a nuk do të jenë asnjëherë të shpërndashme dhe nuk do të preken nga Aksioneri .

KREU V

Neni 34

Dispozita të Fundit

Në rast falimentimi, në lidhje me kujdestarinë dhe me likuidimin e Shoqërisë do të veprohet në përputhje me dispozitat e Ligjit “Për shoqëritë” dhe “Falimentimin” si dhe në përputhje me ligjet e tjera përkatëse.

Për çfarë nuk është shprehur në këtë statut, i referohet dispozitave të legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare.

Neni 32

Bartja e Humbjeve

Pas miratimit të gjendjes financiare të Shoqërisë, humbja e rezultuar në vitin financiar përkatës mund të kalojë në rezultatin financiar të vitit vijues, me qëllim që të mbulohet me fitimet e ardhshme deri në shuarje të saj.

Në këtë rast, Shoqëria detyrohet të respektojë rregullat e vendosura nga Banka e Shqipërisë, sipas kërkesave të kësaj.

Neni 33

Rezerva të Përgjithshme

Rezervat e Përgjithshme të Shoqërisë së Parë të Zhvillimit FAF Sh.a nuk do të jenë asnjëherë të shpërndashme dhe nuk do të preken nga Aksioneri .

KREU V

Neni 34

Dispozita të Fundit

Në rast falimentimi, në lidhje me kujdestarinë dhe me likuidimin e Shoqërisë do të veprohet në përputhje me dispozitat e Ligjit “Për shoqëritë” dhe “Falimentimin” si dhe në përputhje me ligjet e tjera përkatëse.

Për çfarë nuk është shprehur në këtë statut, i referohet dispozitave të legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare.

AKSIONERI
ARBEN AHMETAJ

